



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

MIRATOHET

KRYETARI I K.K.T-së

Z. EDI RAMA

MINISTËR I INFRASTRUKTURES DHE ENERGJISË

Znj. BELINDA BALLUKU

Kryetar i Këshillit Bashkiak

Znj. ROVENA XEKA

Miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak

Nr. 30, datë 24.04.2023

Kryetar i Bashkisë

Z. REDJAN KRALI

DOKUMENTI I RISHIKIMIT TË

PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR

BASHKIA KAVAJË

Miratuar me Vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit Nr. 4, datë 25.04.2023

Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit: Ing. Dëshira QATO



PËRMBAJTA

KREU I.....	3
NDRYSHIME NË RREGULLOREN E PLANIT	3
KREU II.....	11
NDRYSHIME NË TABELAT E TREGUESVE TË ZHVILLIMIT TË NJËSIVE STRUKTURORE	11
<i>SHTOJCA I.....</i>	25
<i>Hartat Ilustruese e njësive strukturore me ndryshime</i>	25
<i>SHTOJCA II.....</i>	26
<i>Koordinatat e njësive strukturore që pësojnë ndryshime të kufijve</i>	26
<i>SHTOJCA III</i>	27
<i>Paraqitja grafike e mbivendosjes së fashave mbrojtëse/të rezervimit të rrugëve kombëtare me Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Kavajë dhe lista e Njësive Strukturore përkatëse.</i>	27



KREU I

NDRYSHIME NË RREGULLOREN E PLANIT

Në "Rregulloren e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Kavajë", bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

1. Në nenin 15 të Rregullores së Planit të Përgjithshëm Vendor, pas pikës 6 shtohet pika 7 me përbajtje si më poshtë:

7. Duke konsideruar që rregulli për madhësinë minimale të parcelës për zhvillim është orientues dhe në kushtet kur madhësitë e parcelave janë të përmasave të ndryshme (jo të standardizuara), atëherë autoriteti i zhvillimit duhet të mbajë në konsideratë si më poshtë:

- në njësitë strukturore ku PPV ka përcaktuar madhësinë minimale për zhvillim në vlerat $500m^2$ ose $600m^2$, do të lejohet zhvillimi edhe në rast se parcelat që kërkojnë zhvillim janë deri në 15% më të vogla se parcela minimale e lejuar;
- në njësitë strukturore ku PPV ka përcaktuar madhësinë minimale për zhvillim në vlerat $1.000m^2$ ose $2.000m^2$, do të lejohet zhvillimi edhe në rast se parcelat që kërkojnë zhvillim janë deri në 12% më të vogla se parcela minimale e lejuar.
- në njësitë strukturore ku PPV ka përcaktuar madhësinë minimale për zhvillim në vlerat $3.000m^2$ ose $5.000m^2$ do të lejohet zhvillimi edhe në rast se parcelat që kërkojnë zhvillim janë deri në 8% më të vogla se parcela minimale e lejuar.
- në njësitë strukturore ku PPV ka përcaktuar madhësinë minimale për zhvillim në vlerat $10.000m^2$ do të lejohet zhvillimi edhe në rast se parcelat që kërkojnë zhvillim janë deri në 5% më të vogla se parcela minimale e lejuar.

2. Në nenin 29, të Rregullores së Planit të Përgjithshëm Vendor, pas pikës 1, shtohen pikat 1/1, 1/2, 1/3, 1/4, 1/5 dhe 1/6, me përbajtje si më poshtë:

1/1. "Vija blu", sipas përcaktimit të VKM Nr. 686/2017 "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit" është vija kufizuese e zhvillimit me funksion mbrojtjen e të gjitha burimeve ujore.

1/2. "Brigjet", janë rripat anësorë të tokës përgjatë deteve, liqeneve, rezervuarëve, lagunave dhe pellgjeve, si dhe përgjatë rrjedhës së shtratit të lumenjve e përrrenjeve.

1/3. "Burimet ujore", janë të gjitha ujërat e brendshme detare, ujërat territoriale, vija bregdetare, zona ekonomike ekskluzive, shelfi kontinental, ujërat sipërfaqësore e nëntokësore, së bashku me shtresat ujëmbajtëse, reshjet atmosferike, nën juridikcionin dhe kontrollin e Republikës së Shqipërisë.

1/4. Veprimtaritë përbri brigjeve, përcaktohen në planet dhe studimet e planifikimit dhe zhvillimit të territorit,



- 1/5. *Bazuar sa më sipër, "vija blu" në Planin e Përgjithshëm Vendor të bashkisë Kavajë përcaktohet nga kufiri i njësive strukturore pjesë e Sistemit Urban që përballen me burimin ujor, dhe në çdo rast "vija blu" duhet të respektojë brigjet ujore, duke mos i tejkaluar ato. Në përcaktimin e vijës blu mbahen në konsideratë edhe përcaktimet e VKM Nr.748, datë 01.12.2022 "Për përcaktimin e zonës, distancës dhe gjërësisë së brigjeve të burimeve ujore".*
- 1/6. *Në rastet kur vija blu e PPV-së tejkalon bregun e përcaktuar me vendime të posaçme të KKU-së, me VKM apo vendime të tjera (sipas legjislacionit sektorial në fuqi), prevalojnë kufizimet/kushtëzimet/rregullat për bregun sipas dispozitave përkatëse.*
3. Pas nenit 29 të Rregullores së Planit të Përgjithshëm Vendor shtohen nenet 29/1, 29/2, 29/3 dhe 29/4 me përbajtje si më poshtë:

Neni 29/1 – Kushte për objektet ekzistuese në sistemin bujqësor dhe natyror

1. *Strukturat e banimit (kategoria A-Banim, BA-Bujqësi-Banim), ekzistuese në momentin e miratimit të PPV-së, të përfshira në sistemin Bujqësor dhe atë Natyror, mund t'i nënshtronen rikonstruksionit dhe rindërtimit, me të drejtë shtesë mbi sipërfaqen e përgjithshme të tyre, vetëm një herë.*
2. *Strukturat e banimit mund të rikonstruktohen si dhe rindërtohen duke shtuar mbi parametrat e gjendjes ekzistuese 1 kat ose 30% të sipërfaqes totale pa kaluar lartësinë maksimale 3 kat. Në rast shtese të vëllimit anësor, shtesa duhet të lejohet vetëm nëse plotësohet kushti që toka të mos ketë bonitet të kategorisë I-IV. Në këto raste (shtesa të vëllimit anësor) koeficienti total i shfrytëzimit të parcelës për ndërtim nuk duhet të kalojë 50%.*
3. *Strukturat ekzistuese të funksionit banim të përfshira në brezat buferik/brezat e rezervimit të burimeve ujore, varrezave, infrastrukturave rrugore, monumenteve të natyrës, monumenteve të kulturës, etj, mund t'i nënshtronen punimeve të rikonstruksionit sipas përcaktimeve të legjislacionit të Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit në fuqi, pa shtesa volumore anësore apo në lartësi.*
4. *Strukturat ekzistuese në momentin e miratimit të PPV-së dhe të paregjistuara, i nënshtronen procedurave në fuqi për legalizimin dhe regjistrimin në Kadastër, edhe në rastet kur përcaktimet e Planit për përdorimin e tokës dhe treguesit e zhvillimit nuk lejojnë zhvillimin, rizhvillimin, ristrukturimin, apo forma të tjera ndërhyrje në territorin ku ato ndodhen.*
5. *Rekomandohet transformimi i strukturave ekzistuese: ish reparte ushtarake jashtë funksionit, banesa, struktura apo objekte sot pa funksion në struktura të Shërbimeve – nënkategorië S1-Shërbime Akomodimi dhe Argëtimi dhe/oze EB3-Agroturizëm. Këto struktura mund të pasurohen me struktura ekologjike Ekoturizmi NAR4 si dhe hapësira për campingje me çadra.*
6. *Strukturat e shërbimit (S-Shërbime), ekzistuese në momentin e miratimit të PPV-së, të përfshira në sistemin Bujqësor dhe atë Natyror, mund t'i nënshtronen rikonstruksionit dhe/oze*



rindërtimit, me të drejtë shtese mbi gjurmën ekzistuese, vetëm në lartësi, vetëm një herë dhe pa kaluar lartësinë maksimale 3K.

7. Strukturat industriale-ekonomike (IE-Industri dhe Ekonomi), ekzistuese në momentin e miratimit të PPV-së, të përfshira në sistemin Bujqësor dhe atë Natyror, mund t'i nënshtronë rikonstruksionit dhe mirëmbajtjes (në kushtet e emergjencës) pa të drejtë shtese vëllimore. Në vazhdimësi, në bashkëpunim me subjektet private-pronare, bashkia duhet të marrë masat për rivendosjen/ zhvendosjen e tyre në territoret e përcaktuara për përdorim të kategorisë IE_Industri dhe Ekonomi.

Neni 29/2: Kufizimi i ndërtimeve përgjatë rrugëve të kategorive A, B dhe C

1. Aplikimi për t'u pajisur me leje zhvillimi dhe ndërtimi në të gjitha njësitet strukturore, të cilat shtrihen përgjatë rrugëve të kategorive A, B dhe C, për atë territor (pjesë të njësisë) që mbivendoset me brezin e rezervuar, referuar Rregullores në zbatim të Kodit Rrugor, (por që nuk është pjesë e zonave të urbanizuara sipas Vendimit të KKT Nr.5, datë 29.12.2014 "Për identifikimin e zonave të urbanizuara në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe miratimin e hartave, ku mund të ndërhyhet në funksion të zhvillimit urban") duhet të kryhet pranë Këshillit Kombëtar të Territorit, dhe të paraprihet nga konfirmimi i Autoritetit Rrugor Shqiptar (për lidhje me, apo dalje në rrugën nationale), duke qenë se këto njësi janë pjesë e brezit të rezervuar të rrugëve nationale, zona të rëndësishë kombëtare në planifikim.
2. Në çdo rast, pavarësisht autoritetit që lëshon lejet e zhvillimit dhe të ndërtimit për struktura përgjatë rrugëve të kategorive A, B dhe C, kërkesat duhet të merren në shqyrtim vetëm nëse strukturat e propozuara kanë akses në rrugët e shërbimit, ose kanë autorizim nga ARSH përlidhje/ dalje në rrugë nationale".
3. Çdo zhvillim në këto njësi duhet të shoqërohet me një brez gjelbërimi të përbërë minimalisht nga dy rreshta bimësie të lartë, paralel me rrugën nationale, që do të shërbejnë si zonë tampon mes zhvillimit të propozuar dhe vetë rrugës nationale të shpejtësisë së lartë".
4. Në çdo rast brezi i rezervuar i rrugëve të kategorisë A, B dhe C duhet të mbetet i lirë nga ndërtimet, me përjashtim të strukturave për shërbime që i shërbejnë transportit dhe lejohen nga Kodi Rrugor.

Neni 29/3: Burimet e ujrage

1. Kushdo ka të drejtë të përdorë lirisht burimet ujore sipërsaqësore për të pirë dhe për nevoja të tjera shtëpiake e të blektorisë, pa tejkaluar nevojat, sasitë e nevojshme për plotësimin e nevojave individuale dhe familjare të përdoruesit dhe në përputhje me ligjet dhe planet përkatëse të këshillave të baseneve.
2. Ndërtimi i puseve, qoftë për përdorim bujqësor dhe industrial, është i pranueshëm vetëm nëse është në përputhje me përcaktimet e legjislativit të posacëm për burimet ujore në filqar.



3. Kushdo ka të drejtë të përdorë ujin e reshejve të shiut që bie në tokë private, me kusht që ky uje tē mos jetë mbledhur në instalime artificiale.

Neni 29/4: Kanalet vaditëse/Emisaret

1. Njësitë që preken/kanë si pjesë përbëresë, ose kufizuese kanalet vaditese/emisaret, duhet të zbatojnë kudrin ligjor të Ligjit Nr. 24/2017 "Për administrimin e ujites dhe tē kullimit".
2. Kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe ndëshkohen si tē tilla:
 - a. ndërtimi, rehabilitimi ose modifikimi i një sistemi ujitje apo kullimi pa lejen përkatëse;
 - b. dëmtimi i sistemit tē ujites, i sistemit tē kullimit ose i veprave tē mbrojtjes nga përmbytja;
 - c. ndërtimi i paautorizuar mbi sistemet e ujites, sistemet e kullimit ose veprat e mbrojtjes nga përmbytja;
 - d. ndërtimi i paautorizuar mbi sistemet e ujites, sistemet e kullimit ose veprat e mbrojtjes nga përmbytja;
 - e. ndërtimi ose ngritja e çdo ndërtese apo strukture, mbjellja e pemëve më afér se 8 metra nga bordura e kanalit kryesor (vija e takimit të sipërfaqes së tokës me skrapatën e kanalit kullues ose vija e takimit të skrapatës së jashtme të bankinës së kanalit ujites me sipërfaqen e tokës), ose e një sistemi kryesor kullimi, apo më afér se 4 metra nga bordura e çfarëdo kanali ujitje ose kullimi.
4. Në nenin 32 tē Rregullores së Planit të Përgjithshëm Vendor, pas pikës 2 shtohen pikat 3, 4 dhe 5 me përbajtje si më poshtë:
 3. Për parcelat që shtrihen në dy apo më shumë përdorime tē ndryshme, lejohet përfshirje e tē gjithë sipërfaqes së parcelës në përllogaritjen e intensitet tē ndërtimit në territorin me përdorimin e tokës me mundësi më tē madhe zhvillimi vetëm nëse:
 - a) Parcelsa ka mbi 50 % të sipërfaqes së saj, në njësinë me tregues zhvillimi më tē lartë;
 - b) Pronari, apo zhvilluesi e kërkon mundësinë e zhvillimit të gjithë parcelës me tē drejta më tē larta zhvillimi, me qëllim që tē gjenerojë zgjerim tē hapësirave me interes publik apo zhvillim në funksion tē shtimit tē shërbimeve tē munguara në zonë.
 4. Parcelat, tē cilat shtrihen në më shumë se një njësi strukturore me mundësi tē ndryshme zhvillimi, mund tē përfshihen në njësinë strukturore me mundësi më tē madhe zhvillimi, vetëm nesë plotësohen dy kushtet e mëposhtme njëkohësisht:
 - a) Një mundësi e tillë kërkohet nga pronari, apo zhvilluesi, dhe;
 - b) Parcelsa/t ka/në mbi 50% të sipërfaqes së saj/tyre në atë njësi strukturore me tregues zhvillimi më tē lartë.
 5. Për tē gjitha rastet e tjera, parcella do tē parashikohet me mundësi tē ndryshme zhvillimi, sipas kufirit tē njësive strukturore, tē cilat do tē orientojnë zhvilluesit përi riparcelizimet e nevojshme sipas mënyrave tē zhvillimit tē përcaktuara në këtë rregullore dhe planet e detajuara vendore.



5. Neni 36/1 "Rregullat për zhvillimet në sistemet Urban, Bujqësor dhe Natyror", ndryshohet si më poshtë:
1. *Në njësitë që i përkasin sistemit Urban, Bujqësor dhe Natyror lejohet zhvillimi i objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, objekteve agroturistike dhe ekoturistike si dhe objekteve sportive, ambiente sportive, terrene sportive dhe mjedise sportive ku zhvillohen një ose disa sporte, në bazë të rregullave teknike, me kusht:*
 - a. *Respektimin e përcaktimeve ligjore në fuqi në fushën e bujqësisë, natyrës, mjedisit, pyjeve e kullotave, zonave të mbrojtura, etj, sipas territorit specifik;*
 - b. *Respektimin e përcaktimeve ligjore sektoriale në fushën e agroturizmit dhe ekoturizmit;*
 - c. *Bashkërendimin dhe marrjen e konfirmimit nga institucionet përgjegjëse për menaxhimin e zonave të mbrojtura dhe zonave të rëndësisë kombëtare, sipas legjislacionit në fuqi;*
 - d. *Respektimin e kontekstit natyror/bujqësor dhe ruajtjen e peizazhit rural;*
 - e. *Sigurimin e pajisjes së strukturave të veprimtarisë agro/ekoturistike me infrastrukturat inxhinierike të nevojshme, sipas legjislacionit përkates;*
 - f. *Moscënimi i infrastrukturës në funksion të tokës bujqësore (kanale kullues/vaditës, rrugë bujqësore, rezervuar, etj).*
 2. *Nëse nuk përcaktohet ndryshe në pasaportën e njësisë strukturore përkatëse apo nga legjislacioni në fuqi, strukturat agroturistike nuk duket të kalojnë 2 kate me nënçati, ndërsa strukturat sportive, duhet të zbatojnë standartet dhe kushtet teknike të projektimit për objekte, ambiente, terrene dhe mjedise sportive.*
 3. *Riparimi, rinovimi, shtesat dhe përshtatja e strukturave ekzistuese të funksioneve të ndryshme në struktura në funksion të agroturizmit, ekoturizmit dhe sporteve është e lejuar me përbushjen e përcaktimeve të këtij nenit dhe në çdo rast, duke respektuar legjislacionin sektorial në fuqi. Strukturat ekzistuese mund të zgjerohen në respektim të pikës 2 të këtij nenit.*
 4. *Bashkia duhet të vijojnë me miratimin e kërkesave për leje zhvillimi/ndërtimi për rastet sipas pikës 1 të këtij nenit, vetëm pas:*
 - a. *marrjes së konfirmimit nga Ministria e Linjës dhe Agjencia e Zhvillimit të Territorit për objektet për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale dhe objektet agroturistike/ekoturistike;*
 - b. *marrjes së konfirmimit nga Agjencia e Zhvillimit të Territorit për objektet sportive, ambiente sportive, terrene sportive dhe mjedise sportive;*
 - c. *njoftimit të Këshillit Kombëtar të Territorit.*
 5. *Nuk lejohet ndryshimi i destinacionit të strukturave sipas pikës 1 të këtij nenit në vijimësi.*

6. Në nenin 41 të Rregullores së Planit të Përgjithshëm Vendor bëhet ndryshimi si më poshtë:



i. Në kreun “B-Rregullat e volumit”:

- a. Pika 1 “Intensiteti maksimal i lejuar i ndërtimit për zonën”, fraza “Në njësinë G1-A21-13, intensiteti për shërbimet e hotelerisë të jetë jo më shumë se 1” ndryshon në “Në njësinë G1-A21-13, intensiteti është 3”;
- b. Pika 2 “Koeficenti maksimal i shfrytëzimit”, shtohet fraza “Për njësinë G1-A21-13, KSHT është 50%.”;
- c. Pika 5 “Lartësia maksimale e lejuar” shtohet fraza “Për njësinë G1-A21-13, lartësia maksimale është 6K”;

7. Në nenin 42 të Rregullores së Planit të Përgjithshëm Vendor bëhet ndryshimi si më poshtë:

i. Në kreun “A-Parashikime të përgjithshme, rregullat e përdorimit dhe kushtet e zhvillimit”:

- a. Pika 3 “Ndërhyrja në zonë” shtohet fraza “Në njësinë K2-A22-03 lejohen edhe përdorimet sipas nenit 66 “S2-Zona Aktivitete Ekonomike”;
- b. Pika 7 “Kushte për PDV” shtohet fraza “Për njësinë G1-A22-03, nuk është i detyrueshëm hartimi i PDV”.

ii. Në kreun “B-Rregullat e volumit”:

- a. Pika 1 “Intensiteti maksimal i lejuar i ndërtimit për zonën” shtohet fraza “Për njësinë G1-A22-03, intensiteti është 2.5”;
- b. Pika 5 “Lartësia maksimale e lejuar” shtohet fraza “Për njësinë G1-A22-03, lartësia maksimale është 5K”.

8. Në nenin 44 të Rregullores së Planit të Përgjithshëm Vendor bëhet ndryshimi si më poshtë:

i. Në kreun “A-Parashikime të përgjithshme, rregullat e përdorimit dhe kushtet e zhvillimit”:

- a. Pika 4 “Qëllimi i ndërhyrjes” shtohet fraza “Për njësinë G1-A23-08 ndërhyrja është “Krijim dhe rigjenerim”.
- b. Pika 7 “Kushte për PDV” shtohet fraza “Përashtim bëjnë njësitë G1-A23-08, G1-A23-10, G2-A23-05 dhe G2-A23-06, për të cilat duhet hartuar PDV”.

9. Në nenin 45 të Rregullores së Planit të Përgjithshëm Vendor bëhet ndryshimi si më poshtë:

i. Në kreun “A-Parashikime të përgjithshme, rregullat e përdorimit dhe kushtet e zhvillimit”:

- a. Pika 3 “Ndërhyrja në zonë” shtohet fraza “Në njësinë S2-A31-02 lejohen edhe përdorimet sipas nenit 66 “S2-Zona Aktivitete Ekonomike” të kësaj rregulloreje”.

10. Në nenin 48 të Rregullores së Planit të Përgjithshëm Vendor bëhet ndryshimi si më poshtë:

Pika 3, gërmë “d”, nga “G1-A41-01” ndryshon në “G1-A41-01, G1-A41-05, G1-A41-06, G1-A41-07, G1-A41-08, G1-A41-09, G1-A41-10 dhe G2-A41-01”.



11. Në nenin 50 të Rregullores së Planit të Përgjithshëm Vendor bëhet ndryshimi si më poshtë:

- i. Në kreun “*A-Parashikime të përgjithshme, rregullat e përdorimit dhe kushtet e zhvillimit*”:
 - a. Pika 7 “*Kushte për PDV*” nga “*Njësitë K1-A41-04, K1-A41-06, K1-A41-08, K1-A41-14 zhillohen pa PDV. Në njësitë e tjera duhet të hartohet PDV*” ndryshon në “*Njësitë K1-A41-04, K1-A41-06, K1-A41-08, K1-A41-09, K1-A41-14 zhillohen pa PDV. Në njësitë e tjera duhet të hartohet PDV*”.

12. Në nenin 53 të Rregullores së Planit të Përgjithshëm Vendor bëhet ndryshimi si më poshtë:

- i. Titulli i nenit, nga “*G1-A41-01*” ndryshon në “*G1-A41-01, G1-A41-05, G1-A41-06, G1-A41-07, G1-A41-08, G1-A41-09, G1-A41-10* dhe *G2-A41-01*”;
- ii. Në kreun “*A-Parashikime të përgjithshme, rregullat e përdorimit dhe kushtet e zhvillimit*”:
 - a. Pika 5 “*Përqindja e sipërfaqes së ndërtimit sipas përdorimit*” shtohet fraza “*Në njësitë G1-A41-08, G1-A41-09 lejohen edhe përdorimet sipas nenit 68 “IS1.Institucion Publike” të kësaj rregulloreje*”.
 - b. Pika 7 “*Kushte për PDV*” shtohet fraza “*Për njësinë G1-A41-10, PDV nuk është e detyrueshme*”.
 - c. Pika 8 “*Madhësia e parcelës*” shtohet fraza “*Për njësinë G1-A41-05 parcela minimale është 2.000m²*”.
- iii. Në kreun “*B-Rregullat e volumit*”:
 - a. Pika 1 “*Intensiteti maksimal i lejuar i ndërtimit për zonën*” nga “*2 në nivel njësie*” ndryshon në “*3.2 në nivel njësie*”;
 - b. Pika 2 “*Koeficenti maksimal i shfrytëzimit*” nga “*40%*” ndryshon në “*45%*”;
 - c. Pika 5 “*Lartësia maksimale e lejuar*”, nga “*5K (lartësia në metra bazohet në funksione)*” ndryshon në “*7K (lartësia në metra bazohet në funksione)*”.



13. Në nenin 59 të Rregullores së Planit të Përgjithshëm Vendor bëhet ndryshimi si më poshtë:

- i. Në kreun “*B-Rregullat e volumit*”:
 - a. Pika 1 “*Intensiteti maksimal i lejuar i ndërtimit për zonën*” nga “*1*” ndryshon në “*Për njësinë G2-A42-01 intensiteti është 3. Për njësinë G2-A42-02 intensiteti është 1*”;
 - b. Pika 2 “*Koeficenti maksimal i shfrytëzimit*” shtohet fraza “*Për njësinë G2-A42-01, KSHT është 50%.*”;
 - c. Pika 5 “*Lartësia maksimale e lejuar*”, shtohet fraza “*Për njësinë G2-A42-01, lartësia është 6K*” (*lartësia në metra bazohet në funksione*).

14. Në nenin 65 të Rregullores së Planit të Përgjithshëm Vendor bëhet ndryshimi si më poshtë:



- i. Në kreun “*B-Rregullat e volumit për njësitë G1-S1-01, G1-S1-02, G1-S1-04, G1-S1-05, G1-S1-06, G1-S1-07, G1-S1-08 dhe S5-S1-01*”:
- a. Pika 1 “*Intensiteti maksimal i lejuar i ndërtimit për zonën*”, shtohet fraza “*Për njësinë G1-S1-08 intensiteti është 3.2*”;
 - b. Pika 2 “*Koeficenti maksimal i shfrytëzimit*” shtohet fraza “*Për njësitë G1-S1-08 KSHT është 45%*.”;
 - c. Pika 5 “*Lartësia maksimale e lejuar*” shtohet fraza “*Për njësitë G1-S1-08 lartësia maksimale është 7K*”.

15. Në nenin 93 të Rregullores së Planit të Përgjithshëm Vendor bëhet ndryshimi si më poshtë:

- i. Në kreun “*B-Rregullat e volumit*”:

 - a. Pika 10 “*Rast i veçantë*”, fraza “*Njësitë G2-B1-03 dhe G3-B1-01 ku rregullat e volumit do të përcaktohen nga studimi i fizibilitetit dhe PDZRK.*” shfuqizohet.



KREU II

NDRYSHIME NË TABELAT E TREGUESVE TË ZHVILLIMIT TË NJËSIVE STRUKTURORE

Në “Tabelat e Treguesve të Zhvillimit të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Kavajë”, në Rregulloren e Planit, bëhen ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë vijon. Paraqitja grafike e ndryshimeve do të bëhet sipas koordinatave në Shtojcën II të këtij dokumenti.

1. Në pasaportat e njësive strukturore sipas shtojcës III, gërmë “a” deri “u” të këtij dokumenti, të prekura nga zonat e rezervimit të akseve rrugore:

- a) Thumanë-Rrogozhinë, kategoria A (min. 60m nga trupi i rrugës);
- b) Durrës-Lushnjë, kategoria A, (min. 60m nga trupi i rrugës);
- c) Karpen-Bardhorë, kategoria C sipas PPV, (min. 30m nga trupi i rrugës)
- d) Karpen-Bardhorë, kategoria C sipas PPV, (min. 10m nga trupi i rrugës)
- e) Luz i Vogël, kategoria C sipas PPV, (min. 30m nga trupi i rrugës),
- f) Luz i Vogël, kategoria C sipas PPV, (min. 10m nga trupi i rrugës),
- g) Vorrozen, kategoria C sipas PPV, (min. 30m nga trupi i rrugës),
- h) Vorrozen, kategoria C sipas PPV, (min. 10m nga trupi i rrugës),
- i) Golemas-Zikularaj, kategoria C sipas PPV, (min. 30m nga trupi i rrugës),
- j) Helmes-Mangaj, kategoria C sipas PPV, (min. 30m nga trupi i rrugës),
- k) Helmes-Mangaj, kategoria C sipas PPV, (min. 10m nga trupi i rrugës),
- l) Shtodhër-Lis Patros, kategoria C sipas PPV, (min. 30m nga trupi i rrugës),
- m) Shtodhër-Lis Patros, kategoria C sipas PPV, (min. 10m nga trupi i rrugës),
- n) Kavaje-Matere, kategoria C sipas PPV, (min. 30m nga trupi i rrugës),
- o) Kavaje-Matere, kategoria C sipas PPV, (min. 10m nga trupi i rrugës),
- p) Golem-Golemas, kategoria C sipas PPV, (min. 30m nga trupi i rrugës),
- q) Golem-Golemas, kategoria C sipas PPV, (min. 10m nga trupi i rrugës),
- r) Hajdaraj-Synej, kategoria C sipas PPV, (min. 30m nga trupi i rrugës),
- s) Hajdaraj-Synej, kategoria C sipas PPV, (min. 10m nga trupi i rrugës),
- t) Rrakull-Shkozet, kategoria C sipas PPV, (min. 30m nga trupi i rrugës),
- u) Rrakull-Shkozet, kategoria C sipas PPV, (min. 10m nga trupi i rrugës),

shtohet kutiza “Kushte të tjera” me frazën “Respektohen përcaktimet e VKM Nr.153, datë 07.04.2000 “Për miratimin e Rregullores në zbatim të Kodit Krugor të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”.



2. Në "Tabelën e Treguesve të Zhvillimit" në njësinë strukturore **A32-119**:

a) Sipërfaqe, nga "2.38 ha" ndryshon në "2.44 ha".

3. Në "Tabelën e Treguesve të Zhvillimit" në njësinë strukturore **AR2-01**:

b) Sipërfaqe, nga "27.51 ha" ndryshon në "27.96 ha".

4. Në "Tabelën e Treguesve të Zhvillimit" në njësinë strukturore **AR2-02**:

a) Sipërfaqe, nga "36.8 ha" ndryshon në "0.08 ha".

5. Në "Tabelën e Treguesve të Zhvillimit" në njësinë strukturore **AR2-03**:

a) Sipërfaqe, nga "36.8 ha" ndryshon në "0.89 ha".

6. Në "Tabelën e Treguesve të Zhvillimit" në njësinë strukturore **AR2-04**:

a) Sipërfaqe, nga "36.8 ha" ndryshon në "1.1 ha".

7. Në "Tabelën e Treguesve të Zhvillimit" në njësinë strukturore **AR2-05**:

a) Sipërfaqe, nga "36.8 ha" ndryshon në "1.61 ha".

8. Në "Tabelën e Treguesve të Zhvillimit" në njësinë strukturore **AR2-06**:

a) Sipërfaqe, nga "36.8 ha" ndryshon në "0.73 ha".

9. Në "Tabelën e Treguesve të Zhvillimit" në njësinë strukturore **AR2-07**:

a) Sipërfaqe, nga "36.8 ha" ndryshon në "4.99 ha".

10. Në "Tabelën e Treguesve të Zhvillimit" në njësinë strukturore **AR2-08**:

a) Sipërfaqe, nga "36.8 ha" ndryshon në "0.76 ha".

11. Në "Tabelën e Treguesve të Zhvillimit" në njësinë strukturore **AR2-09**:

a) Sipërfaqe, nga "36.8 ha" ndryshon në "1.91 ha".

12. Në "Tabelën e Treguesve të Zhvillimit" në njësinë strukturore **AR2-10**:

a) Sipërfaqe, nga "36.8 ha" ndryshon në "2.67 ha".

13. Në "Tabelën e Treguesve të Zhvillimit" në njësinë strukturore **AR2-11**:



a) *Sipërfaqe*, nga "36.8 ha" ndryshon në "2.29 ha".

14. Në "Tabelën e Treguesve të Zhvillimit" në njësinë strukturore AR2-12:

a) *Sipërfaqe*, nga "36.8 ha" ndryshon në "1.38 ha".

15. Në "Tabelën e Treguesve të Zhvillimit" në njësinë strukturore AR2-13:

a) *Sipërfaqe*, nga "36.8 ha" ndryshon në "0.67 ha".

16. Në "Tabelën e Treguesve të Zhvillimit" në njësinë strukturore AR2-14:

a) *Sipërfaqe*, nga "36.8 ha" ndryshon në "0.2 ha".

17. Në "Tabelën e Treguesve të Zhvillimit" në njësinë strukturore AR2-15:

a) *Sipërfaqe*, nga "36.8 ha" ndryshon në "0.22 ha".

18. Në "Tabelën e Treguesve të Zhvillimit" në njësinë strukturore AR2-16:

a) *Sipërfaqe*, nga "36.8 ha" ndryshon në "4.09 ha".

19. Në "Tabelën e Treguesve të Zhvillimit" në njësinë strukturore AR2-17:

a) *Sipërfaqe*, nga "36.8 ha" ndryshon në "6.45 ha".

20. Në "Tabelën e Treguesve të Zhvillimit" në njësinë strukturore AR2-18:

a) *Sipërfaqe*, nga "36.8 ha" ndryshon në "0.86 ha".

21. Në "Tabelën e Treguesve të Zhvillimit" në njësinë strukturore AR2-19:

a) *Sipërfaqe*, nga "36.8 ha" ndryshon në "5.9 ha".

22. Në "Tabelën e Treguesve të Zhvillimit" në njësinë strukturore B2-11:

a) *Sipërfaqe*, nga "5.7 ha" ndryshon në "2.31 ha".

23. Në "Tabelën e Treguesve të Zhvillimit" në njësinë strukturore B2-13:

a) *Sipërfaqe*, nga "45.37 ha" ndryshon në "45.38 ha".

24. Në "Tabelën e Treguesve të Zhvillimit" në njësinë strukturore B2-60:

a) *Sipërfaqe*, nga "10.37 ha" ndryshon në "10.36 ha".



25. Në “Tabelën e Treguesve të Zhvillimit” në njësinë strukturore B2-127:

- a) Sipërfaqe, nga “21.9 ha” ndryshon në “21.77 ha”.

26. Në “Tabelën e Treguesve të Zhvillimit” në njësinë strukturore B3-45:

- a) Sipërfaqe, nga “51.3 ha” ndryshon në “44.04 ha”.

27. Në “Tabelën e Treguesve të Zhvillimit” në njësinë strukturore B3-53:

- a) Sipërfaqe, nga “9.2 ha” ndryshon në “7.05 ha”.

28. Në “Tabelën e Treguesve të Zhvillimit” në njësinë strukturore B3-91:

- a) Sipërfaqe, nga “166.16 ha” ndryshon në “166.14 ha”.

29. Në “Tabelën e Treguesve të Zhvillimit” në njësinë strukturore B3-102:

- a) Sipërfaqe, nga “131.4 ha” ndryshon në “127.54 ha”.



30. Në “Tabelën e Treguesve të Zhvillimit” në njësinë strukturore B3-110:

- a) Sipërfaqe, nga “22.50 ha” ndryshon në “22.57 ha”.



31. Në “Tabelën e Treguesve të Zhvillimit” në njësinë strukturore G1-A11-03:

- a) Sipërfaqe, nga “3.87 ha” ndryshon në “2.90ha”;
b) Koordinatat e njësisë jepen në Shtojcën II.

32. Në “Tabelën e Treguesve të Zhvillimit” në njësinë strukturore G1-A13-01:

- a) Kategoria, nga “A1-Dendësi e ulët banimi” ndryshon në “A4-Zona me funksione mikse”;
b) Përdorimi, nga “A13-Zona të reja me vila” ndryshon në “A41-Zona me funksione mikse urbane”;
c) Njësia, nga “G1-A13-01” ndryshon në “G1-A41-05”;
d) Koeficienti i shfrytëzimit të tokës, nga “40%” ndryshon në “45%”;
e) Intensiteti maksimal i lejuar i ndërtimit, nga “1” ndryshon në “3.2”;
f) Lartësia maksimale e lejuar, nga “2K +1 atik/11m” ndryshon në “7K”;
g) Sipërfaqe, nga “2.4 ha” ndryshon në “3.93 ha”.

33. Në “Tabelën e Treguesve të Zhvillimit” në njësinë strukturore G1-A14-01:

- a) Kategoria, nga “A1-Dendësi e ulët banimi” ndryshon në “A4-Zona me funksione mikse”;
b) Përdorimi, nga “A14-Zona për densifikim urban” ndryshon në “A41-Zona me funksione mikse urbane”;

- c) Njësia, nga "G1-A14-01" ndryshon në "G1-A41-07";
- d) Koeficienti i shfrytëzimit të tokës, nga "30%" ndryshon në "45%";
- e) Intensiteti maksimal i lejuar i ndërtimit, nga "2" ndryshon në "3.2";
- f) Lartësia maksimale e lejuar, nga "4K +1 atik" ndryshon në "7K";
- g) Sipërfaqe, nga "0.91 ha" ndryshon në "2.60ha".
- h) Koordinatat e njësisë jepen në Shtojcën II.

34. Në "Tabelën e Treguesve të Zhvillimit" njësia strukturore G1-A14-03:

- a) Kategoria, nga "A1-Dendësi e ulët banimi" ndryshon në "A2-Dendësi e mesme dhe e lartë banimi";
- b) Përdorimi, nga "A14-Zona për densifikim urban" ndryshon në "A23-Zona për zhvillim";
- c) Njësia, nga "G1-A14-03" ndryshon në "G1-A23-10";
- d) Koeficienti i shfrytëzimit të tokës, nga "30%" ndryshon në "50%";
- e) Intensiteti maksimal i lejuar i ndërtimit, nga "2" ndryshon në "3";
- f) Lartësia maksimale e lejuar, nga "4K +1 atik" ndryshon në "6K".

35. Në "Tabelën e Treguesve të Zhvillimit" në njësinë strukturore G1-A14-04:

- a) Sipërfaqe, nga "4.1 ha" ndryshon në "1.62 ha".

36. Në "Tabelën e Treguesve të Zhvillimit" në njësinë strukturore G1-A21-07:

- a) Sipërfaqe, nga "2.1 ha" ndryshon në "1.3 ha".

37. Në "Tabelën e Treguesve të Zhvillimit" në njësinë strukturore G1-A21-08:

- a) Përdorimi, nga "A21-Zona te formuara me banesa kolektive" ndryshon në "A23-Zona për zhvillim";
- b) Njësia, nga "G1-A21-08" ndryshon në "G1-A23-08";
- c) Koeficienti i shfrytëzimit të tokës, nga "Sipas gjendjes ekzistuese" ndryshon në "50%";
- d) Koeficienti minimal për rrugë, nga "Sipas gjendjes ekzistuese" ndryshon në "30%";
- e) Koeficienti minimal për hapësira publike të hapura, nga "Sipas gjendjes ekzistuese" ndryshon në "30%";
- f) Intensiteti maksimal i lejuar i ndërtimit, nga "20% më shumë se ai ekzistues" ndryshon në "3";
- g) Lartësia maksimale e lejuar, nga "5Kate" ndryshon në "6Kate";
- h) PDV, nga "JO" ndryshon në "PO";
- i) Qëllimi i ndërhyrjes, nga "Sistemim, Rígjenerim" ndryshon në "Krijim dhe ristrukturim".

38. Në "Tabelën e Treguesve të Zhvillimit" në njësinë strukturore G1-A21-13:

- a) Koeficienti i shfrytëzimit të tokës, nga "sipas gjendjes ekzistuese" ndryshon në "50%";

- b) *Intensiteti maksimal i lejuar i ndërtimit*, nga “20% më shumë se ai ekzistues” ndryshon në “3”;
- c) *Lartësia maksimale e lejuar*, nga “5K” ndryshon në “6K”;
- d) *Sipërfaqe*, nga “2.4 ha” ndryshon në “2.84 ha”.

39. Në “Tabelën e Treguesve të Zhvillimit” në njësinë strukturore G1-A21-14:

- a) *Sipërfaqe*, nga “8.76 ha” ndryshon në “7.07ha”.
- b) *Koordinatat e njësisë* jepen në *Shtojcën II*.

40. Në “Tabelën e Treguesve të Zhvillimit” në njësinë strukturore G1-A21-16:

- a) *Kategoria*, nga “A2- Dendësi e mesme dhe e lartë banimi” ndryshon në “A4-Zona me funksione mikse”;
- b) *Përdorimi*, nga “A21- Zona te formuara me banesa kolektive” ndryshon në “A41-Zona me funksione mikse urbane”;
- c) *Njësia*, nga “G1-A21-16” ndryshon në “G1-A41-06”;
- d) *Koeficienti i shfrytëzimit të tokës*, nga “Sipas gjendjes ekzistuese” ndryshon në “45%”;
- e) *Koeficienti minimal përrugë*, nga “Sipas gjendjes ekzistuese” ndryshon në “20%”;
- f) *Koeficienti minimal përhapësira publike të hapura*, nga “Sipas gjendjes ekzistuese” ndryshon në “10%”;
- g) *Intensiteti maksimal i lejuar i ndërtimit*, nga “20% më shumë se ai ekzistues” ndryshon në “3.2”.
- h) *Lartësia maksimale e lejuar*, nga “5Kate” ndryshon në “7Kate”;
- i) *Qëllimi i ndërhyrjes*, nga “Sistemim dhe rigjenerim” ndryshon në “Krijim dhe ristrukturim”.

41. Në “Tabelën e Treguesve të Zhvillimit” shtohet njësia strukturore G1-A21-22:

- a) *Përdorimi*, nga “A21-Zona te formuara me banesa kolektive” ndryshon në “A23-Zona për zhvillim”;
- b) *Njësia*, nga “G1-A21-22” ndryshon në “G1-A23-11”;
- c) *Intensiteti maksimal i lejuar i ndërtimit*, nga “20% më shumë se ai ekzistues” ndryshon në “3”;
- d) *Koeficienti i shfrytëzimit të tokës*, nga “Sipas gjendjes ekzistuese” ndryshon në “50%”;
- e) *Lartësia maksimale e lejuar*, nga “5Kate” ndryshon në “6Kate”.

42. Në “Tabelën e Treguesve të Zhvillimit” në njësinë strukturore G1-A21-24:

- a) *Sipërfaqe*, nga “4.1 ha” ndryshon në “1.15 ha”.

